



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 02/08/2022 Ref.: 1059/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit i Akademisë Evolucion, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Dizajn i Komunikimit, BA*, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik,
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Akademia Evolucion që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Akademia Evolucion që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Akademia Evolucion në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Dizajn i Komunikimit, BA, 180 ECTS Riakreditim	Arta Agani Arsim Shala Lorik Mucaj Shpat Komoni

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datën 14.06.2022 ka organizuar vizitë në Akademia Evolucion me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Diana Milcic dhe Giga Khsitashvili.

Bazuar në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për programin në fjalë, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Dizajn i Komunikimit, BA, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) standarde dhe pjesërisht dy (2) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Akademia Evolucion dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademia Evolucion;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Haxhi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

